



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/117

Datë: 23.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2016, nxjerr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Ndryshohet afati kohor për dërgimin e Projektligjeve për miratim në Qeveri si në vijim:
 - 1.1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim 30.11.2016 (MF);
 - 1.2. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 15.12.2016 (MF).
2. Tërhiqen nga Programi Legjislativ i vitit 2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës këto Projektligje:
 - 2.1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (MAP);
 - 2.2. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (MAP);
 - 2.3. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore (MAP);
 - 2.4. Projektligji për Fondet Investive (MF);
 - 2.5. Projektligji për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës (MF);
 - 2.6. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave (MF);
 - 2.7. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-093 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (MF);
 - 2.8. Projektligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (MF).
3. Ngarkohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/117
Datë: 23.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet me vërejtje Projektligji për Legalizimin e Armëve dhe Dorëzimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municionit dhe Mjeteve Eksplozive.
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në konsultim me Ministrinë e Punëve të Brendshme për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/117


Datë: 23.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Automjete.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/117

Datë: 23.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Financave.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/117

Datë: 23.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për bartjen e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës nga Zyra e Kryeministrit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Zyra e Kryeministrit ngarkohet që të përgatisë plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi nga 01. Janar 2017.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/117

Datë: 23.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës me nr. protokoli 2761/2 datë 02.11.2016, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës shoqërore të evidentuar në emër të P.SH. Shoqata SH.A.M. Vllaznim Bashkim, parcela kadastrale P-7207-0, vendi Lakërishtë, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, për nevoja të akomodimit të Institucionit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Republikës së Kosovës (TRUST), sipas tabelës e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelës së vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokoli 4540/16 datë 14.10.2016.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë në gjykatën kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Fondi i Kursimeve Pensionale të Republikës së Kosovës (TRUST), do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarit të ri. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/117

Datë: 23.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rishikimi Funkcional për Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë me qëllim që të:
 - 1.1. Identifikohen dhe përcaktohen objektivat strategjike dhe zhvillimore për fushën e sundimit të ligjit me qëllim të rritjes së efektivitetit të institucioneve shtetërore në zbatimin e ligjit;
 - 1.2. Rishikohet kuadri ligjor që rregullon fushën e sundimit të ligjit, si dhe proceset dhe bashkëpunimi midis institucioneve që kanë përgjegjësi në fushën e sundimit të ligjit;
 - 1.3. Vlerësohen kapacitetet e institucioneve me përgjegjësi në fushën e sundimit të ligjit;
 - 1.4. Bëhen rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, të proceseve dhe të bashkëpunimit si dhe të kapaciteteve të institucioneve që kanë përgjegjësi në fushën e sundimit të ligjit;
 - 1.5. Përgatitet një Strategji Kombëtare për Sundimin e Ligjit në Kosovë si rezultat i rishikimit funksional.
2. Rishikimi Funkcional do të udhëhiqet nga Ministria e Drejtësisë, e cila për ecurinë, rezultatet dhe rekomandimet e rishikimit funksional i raporton Komitetit Drejtues të përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve si në vijim:
 - 2.1. Ministri për Drejtësi;
 - 2.2. Ministri për Punë të Brendshme;
 - 2.3. Ministri për Financa;
 - 2.4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
 - 2.5. Këshilli Prokurorial i Kosovës;
 - 2.6. Prokurori i Shtetit;
 - 2.7. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës;
 - 2.8. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës;
 - 2.9. Drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës;
 - 2.10. Përfaqësues të donatorëve ndërkombëtarë që ofrojnë asistencë teknike në përkrahje të rishikimit funksional.

3. Komiteti Drejtues ka detyrat si në vijim:
 - 3.1. Të përcaktojë vijat e përgjithshme të ecurisë së rishikimit funksional në bazë të rekomandimeve të Ministrisë së Drejtësisë;
 - 3.2. T'i shqyrtojë dhe t'ia paraqesë Qeverisë së Kosovës gjetjet dhe rekomandimet e rishikimit funksional;
 - 3.3. Të shqyrtojë dhe t'ia paraqesë Qeverisë së Kosovës propozimin për Strategjinë Kombëtare për Sundimin e Ligjit në Kosovë.
4. Ministria e Drejtësisë ka detyrat si në vijim:
 - 4.1. Udhëheq procesin e rishikimit funksional dhe ia paraqet Komitetit Drejtues gjetjet, rekomandimet dhe propozimin e Strategjisë Kombëtare për Sundimin e Ligjit në Kosovë;
 - 4.2. Përcakton strukturën e procesit si dhe organizon, menaxhon dhe mbikëqyrë punën e rishikimit funksional në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatëse që kanë përgjegjësi në fushën e sundimit të ligjit;
 - 4.3. Angazhon ekspertë dhe organizata vendore ose ndërkombëtare për të mbështetur procesin e rishikimit funksional;
 - 4.4. Themelon dhe mbanë Sekretarinë për procesin e rishikimit funksional.
5. Të gjitha institucionet shtetërore kanë për detyrë të bashkëpunojnë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Komitetin Drejtues dhe të caktojnë përfaqësuesit dhe ekspertët e tyre në mekanizmat e rishikimit funksional sipas nevojës dhe në bazë të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë ose të Komitetit Drejtues.
6. Autorizohet Ministria e Drejtësisë të lidhë memorandume të bashkëpunimit me institucionet e pavarura të fushës së sundimit të ligjit me qëllim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në kuadër të procesit të rishikimit funksional.
7. Qeveria e Republikës së Kosovës siguron dhe ndanë mjete financiare që janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për procesin e rishikimit funksional.
8. Procesi i rishikimit funksional fillon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe duhet të përfundojë jo më vonë se me 1 qershor 2018, përveç nëse përcaktohet ndryshe me vendim të Qeverisë.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë